



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës (KP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Pejës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Komuna gjatë ekzekutimit të buxhetit kishte realizuar pagesa në vlerë 2,109,921€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate.

B2 Pasurit kapitale dhe jo kapitale në PVF ishin nënvlerësuar për vlerën 205,189€

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunes së Pejës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B3 Në tri (3) raste janë vërejtur parregullsi në menaxhimin e subvencioneve.
- B4 Në tri (3) raste parregullsi në kontraktimin e qirasë/parkingjeve.
- B5 Në dy (2) raste procesimi i urdhërblerjeve jo sipas rregullave financiare në vlerë prej 20,815€.
- B6 Në pesë (5) raste në vlerë të përgjithshme 346,195€, kemi vërejtur së faturat ishin vonuar për pagesë përtej afatit ligjor prej 30 ditë.
- A1 Në një (1) raste projektit ekzekutues nuk ishte bashkangjitur dosjes së tenderit.
- B7 Në pesë (5) raste vonesa në realizimin e projekteve kapitale, vonesat ishin nga 195 deri në 346 ditë.
- C1 Në një (1) rast komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa mbulese buxhetore në vlerë 1,447,611€.
- A2 Në një (1) rast komuna kishte bërë pagesa pas skadimit të kontratës.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Pejës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Pejës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Pejës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Pejës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rrezeqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunes së Pejës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Çështjet më me fokus dhe që kanë ndikuar në opinionin financiar të auditimit janë ato që kanë të bëjnë me klasifikimin jo të duhur të shpenzimeve, paraqitjen jo të drejtë dhe jo të saktë të detyrimeve kontingjente dhe nënvlerësim i pasurive kapitale dhe jo kapitale.

Fusha për përmirësim të mëtejshëm janë identifikuar tek menaxhimi jo i mirëfilltë kontratave publike, hyrja në obligime kontraktuale në mungesë të buxhetit, mungesa e projektit ekzekutues, Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara, vonesa në pagesën e obligimeve financiare, mangësi në procesin subvencionimit. Kontrollët duhet të forcohen edhe në fushën e menaxhimit të pasurisë, masat duhet të ndërmerren për regjistrimin e pasurisë në regjistra kontabël. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollët e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, tetë (8) të përsëritura dhe dy (2) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2024, ishin realizuar pagesa nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore në vlerë 7,080,020€, nga kjo vlerë për kontratën kolektive ishin paguar 5,479,672€, pjesa tjetër për shpronësim dhe për operator ekonomik në vlerë 1,600,348€. Sipas regjistrimit të komunës borxhi kryesor ishte 5,280,426€, ndërsa 1,799,594€, ishin shpenzime të interesit dhe shpenzime tjera procedurale të gjykatës/përmbarimit.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”, nenit 18 pikës 3 të Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Nga testimi i mostrave kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 2,109,921€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarimor/të gjykatës për paga jubilarë shujta dhe kualifikim për arsimtar nga kategori investimet kapitale 1,708,393€, mallra dhe shërbime dhe komunal 314,528€, dhe nga subvencione dhe transfere 87,000€. Pagesat nga kategoritë ekonomike jo adekuate janë ekzekutuar nga Thesari, në fund të vitit 2024, komuna kishte bërë kërkesës në Ministri për transferim të fondeve nga kategoritë ekonomike, investime kapitale,

mallra shërbime dhe subvencione e transfere në kategorinë e pagave dhe shtesave kjo nuk kishte ndodhur.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Mos regjistrimi i pasurive në regjistra kontabël

Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores Nr. 02/2013 “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Nga testimi i mostrave ka rezultuar se në katër (4) raste në vlerë 27,223€ pasuria jo kapitale nën 1,000€ nuk ishte regjistruar në sistemin e-pasurisë, kurse në dy (2) raste në vlerë 177,966€ pasuria kapitale nuk ishte regjistruar në SIMFK. Po ashtu komuna këto pasuri në nuk i ka shpalosur në aneksin e PVF-ve, si rezultat i mos regjistrimit të pasurive në regjistrin kontabël kemi një nënvlerësim të pasurisë për 205,189€

Sipas analizës së regjistrimit kontabël të pasurive kapitale është vërejtur se në kuadër të kodit ekonomik “32500 Investimet në vijim” nuk janë mbyllur projektet të cilat janë finalizuar, ku nga viti 2006 deri në vitin 2021 ishin në vlerës prej 3,377,774€, përkundër angazhimit të zyrtarit të pasurisë.

Mangësitë e identifikuar kishin ardhur si rezultat i mos-funksionimit të kontroleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive kapitale dhe jo kapitale.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që ka në dispozicion komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe do të rezultojë në prezantimin jo të drejtë dhe të plotë të informatave në PVF.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat kontabël dhe në kategori përkatëse, sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja

Sipas nenit 23 paragrafi 1 Rregullorja MF-Nr.04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatës Jo Qeveritare (OJQ), Monitorimi dhe raportimi projekteve dhe programeve, ku për secilën kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare dhe periudhat raportuese do të përcaktohen me dispozitat e kontratës me përfituesin.

Komuna gjatë viti 2024 kishte ndarë subvencione për mbështetjen e “OJQ-ve, Klubeve sportive të Futbollit, Xhudos dhe Hendbollit” në vlerë prej 51,000€, këto aktivitete kanë të bëjnë me përkrahjen e klubeve në gara të ndryshme sportive.

Mbështetja financiar për klubet e Hendbollit në vlerë 15,000€ dhe Xhudos në vlerë 16,000€ komuna për këto dy (2) raste nuk ka caktuar zyrtaret përgjegjës për monitorimin e implementimit të projekteve.

Përfituesi i mbështetjes financiare “OJQ-Klubi i hendbollit” nuk ka dorëzuar raport financiar dhe narrative për vitin 2024, klubi i Futbollit dhe klubi i Xhudos kanë dorëzuar raporte financiare dhe narrative, por raportet nuk janë sipas kërkesave të përcaktuara me rregulloren përkatëse.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë për zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me subvencionimin e OJQ-ve.

Ndikimi

Mos caktimi i zyrtarëve përgjegjës të cilët duhen të kujdesen për monitorimin e implementimit të projektit, si dhe mos dorëzimi i raporteve narrative dhe financiare për periudhat raportuese, ndikon negativisht dhe krijon vështirësi në menaxhimin e mirëfilltë të subvencioneve.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve të emërohen zyrtarët përgjegjës për monitorimin e implementimit të projekteve, dhe OJQ-të përfituese të dorëzojnë raporte financiare dhe narrative në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mos raportimi mbi ecurinë e zbatimit të kushteve të kontratave për parkingjet e dhëna me qira**Gjetja**

Ligji Nr. 06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 14, pika 2 taksativisht përcakton se propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duhet të identifikojë të dhënat kadastrale të pronës, madhësinë e saj, të specifikojë arsyet, qëllimin, kohëzgjatjen si dhe formën në të cilën rekomandohet procesi për dhënien e pronës në shfrytëzim., Sipas nenit shtatë (7) të Kontratës bazë me Nr. 046/22, kontratës Nr. 045/22 dhe kontrata Nr 06/22 mbikëqyrja e kontratës.

Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, Drejtoria për Çështje Pronësore - Juridike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa mbikëqyrë realizimin e kësaj kontrate, harton raportin për ecurinë e zbatimit të planit dinamik si dhe realizmin e kontratës si tersi duke i rekomanduar Kryetarit marrjen e masave përkatëse në rast të mos përmbushjes së kushteve të kontratës.

Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, Drejtoria për Çështje Pronësore - Juridike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa për vitin 2024 nuk kishte hartuar raportin për ecurinë e zbatimit të planit dinamik dhe zbatimin e kontratës si tersi.

Komuna ka zhvilluar procedurën e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në afate shkurtër prej 10 viteve, Objekti i kontratës ishte se komuna i jepe në shfrytëzim qiramarrësit pronën për qëllim të shfrytëzimit për veprimtari parkingje për vetura.

Me datën 06.01.2022 komuna nënshkruan tri (3) kontrata me operatorë të ndryshëm:

- Kontrata me Nr.046/22 shfrytëzimi i pesë (5) hapësirave në lokacione të ndryshme në Qytet, numri i parkingjeve për shfrytëzim ishte 215; vlera vjetore e qirasë 153,639€.
- Kontrata me Nr.045/22 në vlerë 73,000€ shfrytëzimi i një hapësire publike me sipërfaqe prej 1,271m² me gjithsej 80 parkingje, dhe
- Kontrata me Nr.064/22 në vlerë 25,696€ me sipërfaqe prej 2,768 m² me gjithsej 32 parkingje, afatet e pagesës sipas kontratës janë parapare të kryhen në dy këste brenda vitit muajt mars-shtator.

Shuma e obligimeve të papaguara nga qiramarrësit me datën 31.12.2024 ishte në vlerë 36,500€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë nga drejtorit përkatëse për zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me menaxhimin e kontratave dhënia e hapësirave publike me qira.

Ndikimi

Mangësitë e tilla kanë ndikim në përmbushjen me kohë të obligimeve kontraktuale nga qiramarrësit, vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson apo edhe pamundëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B4

Kryetari të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale, sa i përket pronave të dhëna me qira, të kërkoj nga departamentet përgjegjëse një monitorim të rregullt për tu informuar së janë duke u përmbushur kushtet e

kontratave nga qiramarrësit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare

Gjetja	Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë. Gjatë testimeve kemi identifikuar se në dy (2) raste, në vlerë totale të pagesave 20,815€, Material shpenzues për analiza biokimike 11,502€, Furnizim me uniforma dhe materiale tjera tekstili për QKM-të dhe njësite e saj 9,313€ urdherblerja ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimit të faturës. Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i kontrolleve joefektive, për faktin që nuk janë zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.
Ndikimi	Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, mund të ndikojë në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.
Rekomandimi B5	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja	Sipas nenit 39 të LMFPP-së Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Në pesë (5) raste, faturat në vlerë totale prej 346,195€ të paraqitura në PVF, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë nga 30 ditë deri në 202 ditë. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim të kontratave publike, mungesës së fondeve financiare, fonde të cilat janë shfrytëzuara nga Thesari për ekzekutimin e pagesave vendime gjyqsore në emere të përmbushjes së obligimeve të daluara nga kontrata kolektive.
Ndikimi	Si pasojë e vonesave në pagesën e faturave, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat e shkaktuara të kërkuara nga palët e treta.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë që obligimet financiare të kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja Sipas nenit Nenit 19 specifikimet teknike paragrafi 17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Nga testimi jonë ka rezultuar se në një (1) projekt kapitalë nuk ishte përgatitur projekti ekzekutiv, rasti ka të bëjë me:

Projektet si "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Reka e Allates 770,904€" komuna nuk kishte hartuar projekte ekzekutiv, por kishte inicuar procedurë të prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë.

Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njësive kërkuese pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj me realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të afektojnë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për parane e shpenzuar.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurohet se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e projektit ekzekutiv sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Sipas nenit 70.23 të Rregullave Nr. 001-2022 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.

Në pesë (5) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim:

- Kontrata "Asfaltimi i rrugës për komunitete në Bllagaj, Zllapek pjesa 2" në vlerë 180,786€ nuk është kryer sipas planit dinamik prej 150 ditë.

- Kontrata "Ndërtimi i objektit për qëndrim të përkoshëm (Shtëpia Emergjente)" në vlerë 355,355€ nuk është kryer sipas planit dinamik prej 420 ditë.
- Kontrata "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat Novosellë, Jabllanicë e madhe, Jabllanicë e vogël dhe Radac" në vlerë 280,077€ nuk është kryer sipas planit dinamik prej 150 ditë.
- Kontrata "Hapja, ndërtimi dhe sanimi i kanalit vërshues prej shkollës Xhemail Kada (Furra Husaj) deri te kanali atmosferik Fidanishte dhe Dulia " në vlerë 249,240€ nuk është kryer sipas planit dinamik prej 60 ditë.
- Kontrata "Lot 1 Punimi i ngrohjes, ventilimit dhe ujësjellsit Ritender" në vlerë 150,444€ nuk është kryer sipas planit dinamik 60 ditë.

Vonesat për këto kontrata ishin nga 138 deri 364 ditë. Deri sa ishim nën auditim (mars 2025) asnjëra nga këto projekte nuk ishin të përfunduar.

Shkak i vonesave ishte mungesa e fondeve në dispozicion për të përfunduar kontratën sipas planit dinamik, fondet e projekteve të caktuara ishin shfrytëzuar për pagesën e obligimeve të daluara nga kontrata kolektive, si dhe mos funksionimi i duhur i kontrolleve për të mbajtur përgjegjësit operatorët ekonomike në kryerjen e punimeve sipas afatit të përcaktuar me kontratë.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo, po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Hyrja në obligime kontraktuale pa buxhet dhe fonde të mjaftueshëm

Gjetja

Neni 12 paragrafi 7 i Ligji Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2024, limitet në zotime dhe shpenzime. Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në raste se shpenzime e tilla për kosto totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2024 dhe për dy (2) vitet në vijim, Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale, planifikohen financimin e projekteve dhe shumën e ndarë që duhet të realizohen brenda tri viteve.

Gjatë testimit të mostrave kemi vlerësuar se kontrata Ndërtimi i objektit të ri të Gjimnazit Shkencor Bedri Pejani - ritender ishte nënshkruar më datën 03.06.2024 në vlerë 2,981,010€ kurse me Ligjin e buxhetit për këtë projekt, për tri vite ishin ndarë fonde në vlerë 1,533,399€. Komuna ka hyre në obligime kontraktuale për 1,447,611€ pa pasur buxhet të aprovuar.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur buxhet të aprovuar nga

Kuvendi i Kosovës dhe pa fonde të mjaftueshme.

- Ndikimi** Hyrja në obligime pa planifikime të mjaftueshme buxhetore dhe pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.
- Rekomandimi C1** Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë buxhet të aprovuar dhe fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Pagesa pas skadimit të kontratës

- Gjetja** Sipas Kontratës "Ndërtimi i objektit për qëndrim të përkohshëm (Shtëpia Emergjente)" të nënshkruar me datë 19.08.2022, nenit 2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, ku projekti është planifikuar për vitin 2022 dhe 2023, sipas kushteve e veçanta të kontratës, neni 17.5 data e përfundimit të punimeve 31.12.2023.

Pagesa në vlerë 72,484€ e bërë me datë 20.12.2024 për Ndërtimin e objektit për qëndrim të përkohshëm (Shtëpia Emergjente)" është bërë pas skadimit të kontratës.

Shkak i pagesës pas kontratës ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën si pasojë e planifikimit jo të duhur të projektit dhe të disa problemeve në shpronësimin e pronave, vendosja e afateve për përfundim të kontratës pa një analizë të duhur, si dhe mos përgjegjësia e operatorëve ekonomik në kryerjen e punimeve sipas afatit të paraparë me kontratë.

- Ndikimi** Pagesa pas skadimit të kontratës e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo, po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

- Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i pagesave të bëhet në përputhje me afatet kohore të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2024 ishin në vlerë 5,192,419€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave vetanake, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 1,120,446€ (gjobat në trafik 1,044,141€, të hyrat nga gjykata në vlerë prej 76,305€).

Çështja A3 - Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzim të pronave komunale

Gjetja	Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se “Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t’i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim”. Komuna kishte përgatitur raporte të rregullta gjashtë (6) mujore, mirëpo këto raporte nuk përmbanin informata lidhur me monitorimin e realizimit të kontratave që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. Edhe në vitin 2024, komuna kishte lidhur katër (4) kontrata të reja për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale si dhe kishte ripërtërirë tri (3) kontrata tjera, por nuk kishte raportuar për qëllimin e dhënies në shfrytëzim dhe mbikëqyrjes së tyre. Shkak i ndodhjes është anashkalimi i kërkesave ligjore në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
Ndikimi	Mungesa e raportimit për monitorimin e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore dhe ndikon në realizimin e plotë të të hyrave.
Rekomandimi A3	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Pagat dhe mëditjet ishte 21,118,481€, prej tyre ishin shpenzuar 21,108,803€ apo 100%. Numri i punonjëseve të aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit ishte 2,211 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 2,183, punonjës.

Çështja A4 - Mos finalizimi i rregullores së Organizmin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës

Gjetja

Sipas nenit 34 i Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Komuna ende nuk e kishte finalizuar Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës dhe vënien e saj në zbatim. Drafti është në fazën përfundimtare për tu aprovuar nga ana e DMZP-së dhe e njëjta do të procedohet për Kuvend për Aprovim.

Kjo vjen si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase, mos përgjegjësisë së zyrtarëve përkatës të komunës për të zbatuar kërkesat ligjore.

Ndikimi

Si rezultat i mungesës së Rregullores për Organizmin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës nuk arrihet qëllimi që të krijojë një sistem i njëtrajtshëm i pagave në Komunë që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës si dhe krijimin i një sistemi të pagave dhe shpërblimeve.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që në afatin më të shkurtër janë ndërmarre veprime për dërgimin e rregullores për aprovim në Kuvendin Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 14,534,056€, prej tyre ishin shpenzuar 13,881,847€ apo 95.5%. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, objektet arsimore, mirëmbajtje investive, ujësjellësve, kanalizimeve, pajisje etj.

Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja

Sipas nenit 20.24 pika (f) e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik parasheh se menaxherët e kontratës “Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Nga testimet e bëra, ka rezultuar se në katër (4) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi), si:

- LOT 8 - Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Brestovik në shumë prej 407,000€;
- LOT 7 - Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat; Loxhe, Dardania 3, Graboc, Raushiq dhe Lubeniq në shumë prej 445,423€;
- LOT 1 - Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit Ritender në shumë prej 250,444€;
- Ndërtimi i palestrës në Zahaq RITENDER në shumë prej 855.855€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit.

Ndikimi

Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit e lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin performancën e kontratave.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të sigurojë nga të gjithë menaxherët kontratave që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2024 ka shpalosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 18,265,816€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 18,144,047€, taksat nga qiraja në vlerë 48,358€, të tjera në vlerë 73,411€.

Çështja C2 - Rritja e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë

Gjetja

Neni 26 i Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se “Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove”.

Ligji Nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.06/L-055 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 6 specifikon se për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

Rregulla financiare Nr. 03/2010 për të hyrat, përcakton kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake.

Në krahasim me vitin paraprak, Llogarit e arkëtueshme në vitin 2024 janë rritur për 1,268,074€ apo rreth 8%.

Rritja e llogarive të arkëtueshme është si rrjedhojë e mungesës së kontrolleve të brendshme të mjaftueshme, mungesës së veprimeve të nevojshme dhe mjaftueshme në drejtim të inkasimit të Llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson apo edhe pamundëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi C2

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojnë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	37,457,026	43,223,814	42,469,616	40,240,828	28,763,576
Grante Qeveritare - Buxheti	32,092,009	34,895,564	34,850,160	32,105,989	23,455,986
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	251,913
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,599,327	1,406,774	3,204,030	1,581,174
Të hyrat vetanake	5,365,017	5,365,017	5,082,091	4,638,510	3,194,746
Donacionet vendore	0	65,881	40,409	73,212	0
Donacionet e jashtme	0	1,298,024	1,090,182	219,087	279,758

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 5,766,788€. Kjo rritje ishte nga granditë e Qeverisë prej 2,803,555€, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 1,599,327€, si dhe donacioneve prej 1,363,906€.

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	37,457,026	43,223,814	42,469,616	40,240,828	28,763,576
Pagat dhe mëditjet	18,267,655	21,118,481	21,108,803	19,291,105	14,500,277
Mallrat dhe shërbimet	5,135,500	5,472,375	5,395,811	4,488,837	4,041,842
Komunalitë	947,600	968,653	967,275	909,564	752,993
Subvencionet dhe transferet	1,080,000	1,130,247	1,115,880	958,326	570,394
Investimet Kapitale	12,026,271	14,534,057	13,881,847	14,592,995	8,898,071

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 2,850,827€. Rritja ishte nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave në shumë 2,803.550€ dhe nga donacionet 47,277€. Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 336,875€ nga kjo vlerë: 28,699€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 dhe 308,176€ rritje nga donacionet. Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 21,053 € nga të hyrat vetjake të bartura nga viti 2023.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 50,247€ nga kjo vlerë: 5,321€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 dhe 44,926€ rritje nga donacionet.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,507,786€ nga kjo vlerë: 1,544,254€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 dhe 963,532€ rritje nga donacionet. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve, fushave sportive. Vlen të ceket se thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 1,708,393€, për shujta, kualifikim në arsim obligime të dala nga kontrata kolektive.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024 ishin 5,365,017€, përderisa ishin realizuar 5,192,419€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Të hyrat e grumbulluara nga institucionet nga niveli qendror që u shpërndahen komunave për vitin 2024 janë Gjjobat nga trafiku në shumen prej 1,044,142€ dhe Gjjobat nga Gjykatat në shumen prej 76,305€, (këto të hyra nuk janë të përfshira në planin buxhetor të komunës).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	5,365,017	5,365,017	5,192,419	5,326,833	4,753,464
Të hyrat tatimore	3,255,558	3,255,558	2,208,683	2,761,006	2,354,504
Të hyrat jo tatimore	2,109,459	2,109,459	2,983,736	2,565,827	2,398,960

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 ka rezultuar me 12 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, dy (2) rekomandime janë zbatuar, tetë (8) rekomandime nuk janë adresuar ende, dhe dy (2) rekomandim janë pjesërisht të zbatuara siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ri-destinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale, kontratat të nënshkruhen para fillimisht të periudhës së qirasë duke precizuar afatin e pagesës, periudhën kohore të rrjedhës së obligimeve kontraktuale, si dhetë fillon të zbatohet me nënshkrimin e kontratës, dhe propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës duhet identifikoj paraprakisht sipërfaqen e pronës së dhënë për qira.		Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.		Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve.		Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestnim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuar me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Janë ndërmarrë veprime, nga shtat(7) raste sa ishin në vitin e kaluar në këtë kemi vetëm një (1) rast.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Janë ndërmarrë veprime. Janë përmbushur kërkesat ligjore.	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të ndërmerrë masa në krijimin e mekanizmave të duhur për të siguruar që zyrtarët përgjegjës të kujdesen për monitorimin e implementimit të projekteve. Praktikisht, të siguroj se OJQ-të përfituese të subvencioneve të dorëzojnë raporte financiare dhe narrative.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të rishikojë shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shpesh të kontrollit apo nevojave tjera, për tëu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi

10.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore. Po ashtu, duhet të sigurojë hartimin e një rregullore të brendshme për menaxhimin e pasurive jo financiare, e cila duhet të përfshijë rregulla dhe procedura të qarta për identifikimin, dokumentimin, mbajtjen, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë kontrollin efikas në arkëtimin e të hyrave dhe mbledhjen e të arketueshëmve. Masat e parapara në kontratë/ shkëputje të kontratës duhet të zbatohen me qëllim të vetëdijesimit dhe rritjes së përgjegjësisë së qiramarrësve/obliguesve ndaj Komunës.	Janë ndërmarrë veprime të pjesëshme.	Pjesërisht i zbatuar
12.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare të kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit




Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit




Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	Nuk pajtohem me Çështjen B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, sepse Komuna e Pejës përmes Kuvendit Komunal ka marrë dy vendime për transferimin e mjeteve në kategoritë ekonomike Paga dhe Mëditja, sipas Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2024, Neni 15, Paragrafi 7.	Komuna në komentin e dhënë ka bërë vetëm arsyetime pa ofruar ndonjë dëshmi që do të ndikonin në ndryshimin e gjetjes. Prandaj, gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit


Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Pejës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Nuk pajtohem me Çështjen B1 – Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, sepse Komuna e Pejës përmes Kuvendit Komunal ka marrë dy vendime për transferimin e mjeteve në kategoritë ekonomike Paga dhe Meditja, sipas Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2024, Neni 15, Paragrafi 7.
- Tek çështjet e tjera pajtohem.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Gazmend Muhaxheri

Data: 20. qershor 2025, Pejë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.